

“ANKETA E ZËRIT TË QYTETARËVE”

Reforma Territoriale dhe Administrative në Shqipëri

Permbledhje raporti

Organizuar dhe zbatuar nga  **IDRA**
RESEARCH & CONSULTING



Përmbajtja

| | |
|--|-------------------------------------|
| Hyrje..... | 3 |
| Si të lexojmë raportin?..... | 4 |
| Përmbledhje Ekzekutive..... | 6 |
| Zonat e reja – Varianti me 61 njesi | 8 |
| Metodologjia..... | 18 |
| Përzgjedhja e Njësive Primare të Kampionimit (NJK) | 18 |
| Përzgjedhja e Derës/Shtëpisë ku do të trokitet..... | 19 |
| Përzgjedhja e Personit që do të intervistohet | 19 |
| Intervistuesit | 20 |
| Rezultatet sipas zonave funksionale | Error! Bookmark not defined. |

Hyrje

“Anketa e zërit të qytetarëve” për Reformën Territoriale-Administrative është ndërmarrë nga Qeveria shqiptare dhe mbështetur financiarisht nga Projekti STAR (Support to Territorial and Administrative Reform)¹.

Në kuadër të përfshirjes së zërit të qytetarëve si dhe në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 8652 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një projekt për të krijuar një platformë të strukturuar për mbledhjen e opinionit të qytetarëve në lidhje me reformën territoriale të propozuar.

“Anketa e zërit të qytetarëve” është një projekt që synon të mbledhë nëpërmjet një kampioni/mostre përfaqësuese, opinionet e qytetarëve në lidhje me:

- 1 – Njohuritë që kanë qytetarët për aspekte të ndryshme të reformës
- 2 – Nivelin e mbështetjes apo kundërshtimit që shfaqin qytetarët për nevojën e reformës në parim
- 3- Nivelin e mbështetjes apo kundërshtimit që shfaqin qytetarët në lidhje me propozimet specifike për ndarjen e re administrative të propozuar nga Qeveria
- 4 – Arsyet e mbështetjes apo kundërshtimit
- 5 – Perceptime të ndryshme mbi problematikën me të cilën përballlet qeverisja vendore

Rreth **16 000 qytetarë** në moshë madhore (18 vjeç e sipër) të ndarë sipas kampioneve të zonave funksionale nga variantet e propozuara janë pyetur nëpërmjet një pyetësi të strukturuar.

Mbledhja e të dhënave në terren është kryer në periudhën **15 Qershor 2014 – 17 Korrik 2014.**

1 Projekti STAR zbatohet përmes një fondi të krijuar nga shumë donatorë dhe me mekanizmat menaxhues të PNUD-it në Shqipëri. Projekti synon që të lehtësojë dhe mobilizojë të gjitha burimet njerëzore të nevojshme dhe logjistikën që kërkohet për kryerjen e reformes territoriale. STAR financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunimin Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, USAID-i dhe PNUD-i.

Si të lexojmë raportin?

Indekset e paraqitura ne raport janë:

- **Njohuria mbi reformën**

Ky indeks bazohet në përgjigjet që dalin nga pyetja **“Në lidhje me reformën territoriale që po diskutohet aktualisht ne Shqipëri, sa të informuar jeni me aktivitetin dhe përmbajtjen e saj? Në shkallën nga 1 deri në 7, ku 1 është “Aspak të informuar” dhe 7 është “Shumë të informuar”**. Indeksi është një mesatare e shkallës së shprehur. Mesi i shkallës konsiderohet numri 4. Nje numër më i vogël se 4 do të thotë “më së shumti i painformuar” dhe një numër më i madh se 4 do të thotë “më së shumti i infomuar”.

Duhet pasur parasysh se ky indeks nuk paraqet opinionin e qytetarëve mbi ekzistencën apo jo të reformës, por deklarimin e tyre në lidhje me informimin mbi përmbajtjen, detajet dhe aktivitetet e reformës. Një qytetar mund të jetë në dijeni se një reformë e tillë po zbatohet, por nuk është domosdoshmërisht në dijeni të përmbajtjes specifike të reformës.


- **Njohja e propozimit specifik**

Ky indeks bazohet në rezultate që dalin nga pyetja **“A jeni në dijeni për propozimin e ri mbi ndarjen e njësisë tuaj qeverisese vendore?”**. Pasi i intervistuari jep përgjigjen e tij, Anketuesi bën pyetje kontrolluese për të parë nëse personi vërtet është në dijeni. Indeksi përfaqëson % e atyre që pohojnë se e njohin propozimin/propozimet specifike.

- **Mbeshtetja e reformës në parim**

Ky indeks bazohet në rezultate që dalin nga pyetja **“Para se të shqyrtojmë kufijtë e rinj administrative të propozuar nga reforma për zonën tuaj specike, sa e mbështesni ose kundërshtoni ju nevojën për të patur një reformë territoriale dhe ndarje të re administrative në Shqipëri? Në shkallën nga 1 deri në 7, ku 1 është “E kundërshtoj plotësisht” dhe 7 “E mbështes plotësisht.”** Indeksi është një mesatare e shkallës së shprehur. Mesi i shkallës konsiderohet numri 4. Një numër më i vogël se 4 do të thotë “më se shumti kundër” dhe një numër më i madh se 4 do të thotë “më së shumti pro”.

Ky indeks paraqitet edhe në formën e përqindjes në raport sipas figurës në krah. Përgjigjet 5, 6 dhe 7 përbëjnë



ata që janë në “mbështetje” të reformës. Përgjigja 4 përmbledh ata që janë “neutral” në lidhje me refomën dhe përgjigjet 3,2,1 përmbledh ata që janë “kundër” refomës.

- **Mbështetja e variantit specifik të ndarjes (variant me 39 njësi dhe variant me 47 njësi)**

Indeksi bazohet në rezultate që dalin nga pyetja **“Sipas propozimit të ri mbi ndarjen e njësisë tuaj, sa shumë e mbështesni ose e refuzoni atë, në një shkallë nga 1 deri në 7, ku 1 është “E kundërshtoj plotësisht” dhe 7 “E mbështes plotësisht”?** Intervistuesit janë të gjithë të pajisur me një hartë të njësisë së propozuar për të qenë sa më të qartë në propozimin specifik, duke ja u treguar të intervistuarve, pavarësisht nëse ata deklarojnë se i njohin apo jo detajet e ndarjes së re . Indeksi është një mesatare e shkallës së shprehur. Mesi i shkallës konsiderohet numri 4. Një numër më i vogël se 4 do të thotë “më së shumti kundër” dhe një numër më i madh se 4 do të thotë “më së shumti pro”.

Ky indeks paraqitet edhe në formën e përqindjes në raport sipas figurës më lart. Përgjigjet 5, 6 dhe 7 përmbledhin ata që janë në “mbështetje” të ndarjes specifike të propozuar. Përgjigja 4 përmbledh ata që janë “neutral” në lidhje me këtë ndarje dhe përgjigjet 3,2,1 përmbledhin ata që janë “kundër” ndarjes.

Për njësitë të cilat ndryshojnë nga varianti me 49 njësi tek ai me 39 njësi, të intervistuarit janë pyetur për të dy variantet.

Shëmbull: *Popullsia e Kamzës jep opinion në lidhje me variantin me 47 njësi, ku Kamza është e bashkuar me Komunën e Zall Herrit dhe Paskuqanit, por edhe për variantin me 39 njësi ku Kamza është pjesë e njësisë së Tiranës.*

Në rastin kur të dhënat janë përpunuar në nivel kombëtar ato janë peshuar sipas përqindjes që popullsia e zonave funksionale zë në totalin e popullsisë së Shqipërisë.

Përmbledhje Ekzekutive

Të pyetur për nevojën e një reforme territoriale në parim, qytetarët kanë shprehur një **mbështetje të lartë** në këtë drejtim. Në nivel kombëtar rreth 67% e qytetarëve kanë shprehur mbështetje për reformën në parim, rreth 12% janë shprehur neutral dhe vetëm 21% janë shprehur kundër reformës në parim.

Niveli i mbështetjes, duke konsideruar shkallën nga 1 në 7 ku 1 është “E kundërshtoj plotësisht” dhe 7 është “E mbështes plotësisht”, është mbi mesataren (5.1). Njësitë me nivel të lartë mbështetjeje për nevojën e një reforme territoriale janë Divjaka (6.4), Patosi (6.4), Berati (6.2), Lushnja (6.1), Skrapari (5.9), Fieri (5.8) dhe Himara (5.8). Nga ana tjetër njësitë funksionale që nuk e konsiderojnë shumë të nevojshme ndarjen e re të territorit janë Mati (3.6), Malësia e Madhe (4.2), Livadhja (4.2) dhe Kamza (4.3).

Qytetarët janë pyetur më pas në lidhje me variantet specifike të ndarjes së njësisë së tyre (varianti me 39 njësi dhe varianti me 47 njësi). Pavarësisht nëse qytetarët e njohin apo jo propozimin specifik, anketuesit u kanë treguar dhe shpjeguar në hartë ndarjen e re përpara se ti pyesin për nivelin e mbështetjes që ata kanë në lidhje me këtë ndarje të re. Në përgjithësi popullata ka shprehur mbështetje të lartë edhe për propozimet specifike.


Qytetarët e anketuar për propozimet specifike të ndarjes administrative përgjithësisht kanë dhënë mbështetje si për variantin me 47 njësi edhe për variantin me 39 njësi.

Varianti me 39 njësi funksionale është më pak tërheqës për Cërrikun (2.0)², Durrësin (3.5)³, Patosin (3.7)⁴, Shkodrën (3.8)⁵ dhe Shijakun (3.8).

² Cërriku në variantin me 39 njësi është bashkë me Elbasanin. Në këtë rast popullata e Cërrikut nuk ka shprehur mbështetje për këtë variant.

³ Varianti 39 për Durrësin është bashkimi me Shijakun. Në këtë rast as Durrësi por as Shijaku nuk kanë shprehur mbështetje të madhe për këtë variant.


Mbështetja në parim për reformën




“Anketa e zërit të qytetarëve”

Varianti me 47 njësi funksionale ka gjetur mbështetje të lartë në njësitë e Beratit (6.5), Pogradecit (6.4) dhe Kolonjës (6.0).

Mbështetja për variantin me 47 njësi (sipas çdo njësie)



Mbështetja për variantin me 39 njësi (sipas çdo njësie)



Në seksionin më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur rezultatet kryesore për çdo njësi më vete.

⁴ Patosi në variantin 39 është bashkë me Fierin. Në këtë rast Patosi nuk ka shprehur mbështetje të madhe për këtë variant.

⁵ Shkodra në variantin 39 bashkohet me Vaun e Dejës. Popullata shkodrane është më pak në favor të këtij varianti.

“Anketa e zërit të qytetarëve”

| | Njesia | Varianti 47 (me shkrim te theksuar janë bashkitë) | Varianti 39 (me shkrim te theksuar janë bashkitë) | Permbledhje e gjetjeve kryesore |
|---|---------------|---|--|--|
| 1 | Berat | Berat, Ura Vajgurore, Poshnje, Kutalli, Cukalat, Sinje, Terpan, Velabisht, Vertop, Roshnik, Otlak | idem | 86% e kampionit te njesise e mbeshtesin nevojen per reformen territoriale 94% e te anketuarve te njesise e mbeshtesin propozimin specifik per ndarjen e zones se tyre |
| 2 | Bulqize | Bulqize, Martanesh, Fushe Bulqize, Shupenze, Gjorice, Zerqan, Ostren, Klenje | idem | 67% e kampionit te njesise e mbeshtesin nevojen per reformen territoriale 70% e kampionit te njesise e mbeshtesin propozimin specifik per ndarjen e zones se tyre |
| 3 | Cerrik | Cerrik, Belsh, Gostime, Klos, Mollas, Grekan, Kajan, Fierze, Rrase, Shales | Elbasan, Cerrik, Belsh, Gostime, Klos, Mollas, Grekan, Kajan, Fierze, Rrase, Shales, Bradashesh, Funar, Gjergjan, Gjinar, Gracen, Labinot Fushe, Labinot Mal, Paper, Shirgjan, Shushice, Tregan, Zavaline | Rreth 83% e te intervistuarve te njesise e mbeshtesin nevojen per nje ndarje te re territoriale 66% e kampionit te njesise jane kunder propozimin per ndarjen me 39 zona ku Cerriku eshte pjese e Elbasanit Rreth 75% e kampionit te njesise mbeshtesin propozimin per ndarjen me 47 zona ku Cerriku eshte njesi me vete |
| 4 | Delvine | Delvine, Vergo | idem | Rreth 61% e kampionit te Delvines jane pro nevojes per reformen territoriale Rreth 55% e kampionit te njesise jane pro propozimit specifik per ndarjen e zones se Delvines |
| 5 | Devoll | Bilisht, Proger, Hociisht, Miras, Qender | idem | Rreth 54% e te intervistuarve ne kete njesi e mbeshtesin nevojen per reformen territoriale 76% e tyre jane pro ndarjes specifike per njesine funksionale te Devollit |
| 6 | Diber | Peshkopi, Lure, Zall-Rec, Zall-Dardhe, Arras, Fushe-Cidhen, Muhur, Selishte, Luzni, Kastriot, Sillove, Kalaja e Dodes, Tomin, Melan, Maqellare | idem | 55% e te intervistuarve ne Diber e mbeshtesin nevojen per nje ndarje te re territoriale 77% e kampionit jane pro ndarjes territoriale per njesine e Dibres |
| 7 | Divjaka | Divjake, Terbuf, Grabian, Gradishte, Remas | Lushnje, Divjake, Terbuf, Grabian, Gradishte, Remas, Allkaj, Ballagat, Bubullime, Dushk, Fier Shegan, Golem, Hysgjokaj, Karbunare, | 84% e kampionit te Divjakes jane pro nevojes per nje ndarje te re territoriale 49% jane pro variantit 39 ku Divjaka eshte pjese e Lushnjes nderkohe qe 48% jane kunder ketij propozimi 73% e te anketuarve jane pro variantit me 47 ndarje ne te cilin Divjaka eshte njesi me vete |

“Anketa e zërit të qytetarëve”

| | | | Kolonje, Krutje | |
|----|-------------|--|--|---|
| 9 | Durres | Durres, Sukth, Rrashbull, Katund I Ri, Ishem | Durres, Sukth, Shijak, Manez, Rrashbull, Katund I Ri, Ishem, Gjepalaj, Maminas, Xhafzotaj | 79% e kampionit te Durresit e mbeshtesin nevojen per nje ndarje te re territoriale 46% e kampionit jane pro variantit 39 ku Durresi, Sukthi, Shijaku dhe Manezi jane bashki me 6 komuna te tjera 71% e te intervistuarve jane pro variantit 47 ku Durresi dhe Sukthi jane bashki me 3 komuna te tjera ne kete njesi |
| 10 | Elbasan | Elbasan, Bradashesh, Funar, Gjergjan, Gjinar, Gracen, Labinot Fushe, Labinot Mal, Paper, Shirgjan, Shushice, Tregan, Zavaline | Elbasan, Cerrik, Belsh, Gostime, Klos, Mollas, Grekan, Kajan, Fierze, Rrase, Shales, Bradashesh, Funar, Gjergjan, Gjinar, Gracen, Labinot Fushe, Labinot Mal, Paper, Shirgjan, Shushice, Tregan, Zavaline | Rreth 73% e te intervistuarve ne kete zone funksionale mbeshtesin nevojen per nje ndarje te re territoriale 50% jane pro variantit me 39 njesi ku Elbasani perfshin edhe Cerrikun brenda njesise se vete territoriale 80% pre tyre jane pro variantit me 47 njesi ne te cilin Elbasani nuk e permban Cerrikun brenda njesise se vete. |
| 11 | Fier | Fier, Libofshe, Topoje, Dermenas, Qender, Levan, Frakull, Cakran, Portez, Zharrez, Mbrostar | Fier, Patos, Roskovec, Libofshe, Topoje, Dermenas, Qender, Levan, Frakull, Cakran, Portez, Zharrez, Mbrostar | 56% e kampionit te Fierit nuk e mbeshtesin nevojen e nje reforme territoriale nderkohe qe 27% e tyre jane pro nevojtes per te 74% e tyre jane pro variantit 39 ne te cilin Fieri, Patosi dhe Roskoveci jane bashki se bashku me 10 komuna 65% e tyre jane pro variantit 47 ne te cilin vetem Fieri eshte bashki me 10 komuna per kete njesi |
| 12 | Gjirokaster | Gjirokaster, Libohove, Picar, Odrie, Zagori, Cepo, Lunxheri, Antigone, Lazarat, Qender Libohove | idem | 77% e kampionit te Gjirokastrës e mbeshtesin nevojen per nje ndarje te re territoriale 85% e te anketuarve jane pro ndarjes specifike per kete njesi me Gjirokastrën dhe Libohoven si bashki |
| 13 | Gramsh | Gramsh, Sult, Tunje, Pishaj, Porocani, Kodovjat, Kukur, Lenie, Skenderbegas, Kushove | idem | 62% e te anketuarve ne Gramsh mbeshtesin nevojen ndarjen e re territoriale 83% jane pro variantit specifik per ndarjen e kesaj njesie me Gramshin si bashki dhe 9 komune perberese |
| 14 | Has | Krume, Gjinaj, Golaj, Fajze | idem | |

“Anketa e zërit të qytetarëve”

| | | | | |
|----|---------|--|---|---|
| | | | | 64% e kampionit të Hasit e mbështesin parimisht nevojën për një ndarje të re territoriale 88% e tyre e mbështesin ndarjen specifike të njësive të Hasit me Krume si bashki dhe tre komuna të tjera |
| 15 | Himare | Himare , Lukove, Vranisht | Vlora, Himara, Oriku, Selenice , Armen, Brataj, Kote, Novosele, Qender, Sevaster, Shushice, Vllahine, Vranisht | Rreth 80% e kampionit të njësive të Himarës mbështesin parimisht nevojën për reformat territoriale 60% e tyre janë pro variantit 47 në të cilin Himara është njësi funksionale me vetë së bashku me Lukoven dhe Vranishtin. 37% janë kundër këtij propozimi. |
| 16 | Kamez | Kamez , Zall Herr, Paskuqan | Tirana, Vore, Kamez , Zall Herr, Paskuqan, Baldushk, Berxulle, Berzhite, Dajt, Farke, Kashar, Krrabe, Ndroq, Petrele, Peze, Preze, Shengjergj, Vaqarr, Zall Bastar | 39% e të intervistuarve në Kamez janë parimisht dakord për ndarje të re territoriale ndërkohë që 37% nuk janë dakord. 24% e tyre janë neutral 67% e të anketuarve janë pro versionit 39 në të cilin Kamza është pjesë e njësive të Tiranës 48% prej tyre janë pro versionit 47 në të cilin Kamza është njësi me vetë e përbërë Paskuqani dhe Zall Herri |
| 17 | Kavaje | Kavaje, Rrogozhine , Golem, Helmas, Lekaj, Sinaballaj, Gose, Kryevidh, Synej, Luz I vogël | idem | Rreth 64% e kampionit në Kavaje janë parimisht dakord për nevojën e një ndarje të re territoriale 77% e të intervistuarve në Kavaje janë dakord me ndarjen specifike të kësaj njësie |
| 18 | Kolonje | Erseke, Leskovik , Clirim, Mollas, Novosele, Qender, Barmash, Leskovik | idem | 72% e të intervistuarve në Kolonje mbështesin parimisht nevojën për një ndarje të re territoriale 85% e tyre janë pro propozimit specifik për ndarjen e njësive territoriale të Kolonjes |
| 19 | Korce | Korce , Lekas, Voskopoje, Voskop, Qender, Drenove, Mollaj, Vithkuq | Korce, Maliq , Lekas, Voskopoje, Voskop, Qender, Drenove, Mollaj, Vithkuq, Moglice, Gore, Libonik, Pojan, Vreshtas, Pîrg | 60% e kampionit të kësaj njësie janë parimisht dakord për nevojën e një ndarje të re territoriale 80% janë pro variantit 39 në të cilin Korca dhe Maliqi janë bashki të përbëra nga 13 komuna në njësi 56% janë pro variantit 47 në të cilin Korca është bashkia e vetme me 7 komuna në njësi |
| 20 | Kruje | Kruje, Fushe Kruje , Bubq, Cudhi, Koder Thumane, Nikel | idem | 71% e kampionit të kësaj njësie janë parimisht dakord për një nevojën e një reforme territoriale 85% e të anketuarve janë pro ndarjes specifike për këtë njësi |
| 21 | Kucove | Kucove , Perondi, Kozare, Lumas | idem | 87% e kampionit të kësaj njësie janë parimisht dakord për nevojën e një ndarje të re të territorit 95% e të intervistuarve janë pro ndarjes specifike të njësive të Kucoves |

“Anketa e zërit të qytetarëve”

| | | | | |
|----|----------|---|--|---|
| 22 | Kukes | Kukes , Arren, Bicaj, Bushtrice, Gryke Cajë, Kalis, Kolsh, Malzi, Shishtavec, Shtiçen, Surroj, Terthore, Topojan, Ujmisht, Zapod | idem | 67% e kampionit të kesaj njesie janë dakord parimisht për nevojën e ndarjes së re territoriale 79% e kampionit të Kukesit janë pro ndarjes specifike të njesisë së tyre territoriale |
| 23 | Kurbin | Lac, Mamurras , Milot, Fushekuqe | idem | 74% e kampionit të kesaj njesie e mbështesin nevojën e një ndarje të re territoriale 78% e të anketuarve janë pro versionit specifik për ndarjen e njesisë së Kurbinut |
| 24 | Lezhe | Lezhe , Shengjin, Shenkoll, Zejmen, Kolc, Kallmet, Ungrej, Blinisht, Dajç, Balldren I Ri | idem | Rreth 67% e të intervistuarve në këtë njësi janë parimisht dakord për nevojën e një reforme territoriale 74% e të anketuarve janë pro variantit specifik për ndarjen territoriale të njesisë së tyre |
| 25 | Librazhd | Librazhd, Prrerjas , Hotolisht, Lunik, Orenjë, Polis, Qender, Qukes, Rajçe, Stebleve, Stravaj | idem | 80% e të intervistuarve në këtë njësi mbështesin nevojën për një ndarje të re territoriale 66% e tyre janë pro variantit specifik për ndarjen territoriale të njesisë së Librazhdit |
| 26 | Livadhja | Livadhja, Aliko, Dhiver, Mesopotam, Finiq | idem | 51% e kampionit të kesaj njesie mbështesin nevojën për reforme territoriale ndërkohë që 39% e tyre nuk janë dakord për nevojën e saj 71% e të anketuarve janë pro versionit specifik për ndarjen territoriale të njesisë së tyre |
| 27 | Lushnje | Lushnje , Allkaj, Ballagat, Bubullime, Dushk, Fier Shëgan, Golem, Hysgjokaj, Karbunare, Kolonjë, Krutje | Lushnje, Divjake , Terbuf, Grabian, Gradishtë, Remas, Allkaj, Ballagat, Bubullime, Dushk, Fier Shëgan, Golem, Hysgjokaj, Karbunare, Kolonjë, Krutje | 85% e të intervistuarve në këtë njësi janë parimisht dakord për nevojën e një ndarje të re territoriale 96% janë pro variantit 39 me Lushnjën dhe Divjakën si bashki së bashku me 14 komuna përberese në njësi 69% janë pro variantit 47 me Lushnjën si bashki dhe 10 komuna përberese në njësi funksionale |

“Anketa e zërit të qytetarëve”

| | | | | |
|----|----------------|---|---|--|
| 28 | Malesi e Madhe | Koplik , Kelmend, Kastrat, Shkrel, Qender, Gruemire | idem | 45% e të intervistuarve në këtë njësi janë parimisht dakord për një ndarje të re territoriale ndërkohë që 37% janë kundër kësaj ideje Rreth 59% e tyre mbështesin variantin specifik për ndarjen e kësaj njësie funksionale |
| 29 | Maliq | Maliq , Moglice, Gore, Libonik, Pojan, Vreshtas, Pirg | Korca, Maliq , Lekas, Voskopojë, Voskop, Qender, Drenovë, Mollaj, Vithkuq, Moglice, Gore, Libonik, Pojan, Vreshtas, Pirg | 70% e kampionit të kësaj njësie janë parimisht dakord për nevojën e një reforme territoriale 73% janë pro variantit 39 në të cilin Korca dhe Maliq janë bashki së bashku me 13 komuna të tjera në njësi 59% janë pro variantit 47 në të cilin Maliqi është njësi me vetë si bashki e përbërë nga 6 komuna të tjera |
| 30 | Mallakaster | Ballsh , Aranitas, Fratar, Greshicë, Hekal, Kute, Ngracan, Qender, Selite | idem | 69% e të intervistuarve në këtë njësi mbështesin parimisht nevojën për një reforme territoriale 77% e të anketuarave janë pro versionit specifik për Mallakastren si njësi me vetë me Ballshin bashki dhe 8 komuna |
| 31 | Mat | Burrel, Klos , Ulez, Baz, Rukaj, Derjan, Macukull, Komsj, Lis, Suc, Gurre, Xiber | idem | 51% e të intervistuarve në këtë njësi nuk e mbështesin nevojën për një ndarje të re territoriale ndërkohë që 39% janë dakord 54% e tyre janë pro variantit specifik të ndarjes territoriale të njësisë së Matit |
| 32 | Mirdita | Rreshen, Rubik , Kacinar, Fan, Orosh, Selite, Kthjelle | idem | Rreth 64% e të anketuarave mbështesin parimisht nevojën për një ndarje të re territoriale 79% e kampionit të Mirditës janë pro variantit specifik të ndarjes së njësisë së tyre |
| 33 | Patos | Patos, Roskovec , Strum, Kuman, Rruzhdie, Kurjan | Fier, Patos, Roskovec , Libofshe, Topojë, Dermenas, Qender, Levan, Frakull, Cakran, Portez, Zharrez, Mbrostar | 91% e tyre mbështesin parimisht nevojën për një ndarje të re territoriale 58% janë pro versionit 39 në të cilin Patosi është pjesë e njësisë së Fierit 45% janë pro versionit 47 në të cilin Patosi është njësi me vetë dhe e ndarë nga Fieri |

“Anketa e zërit të qytetarëve”

| | | | | |
|----|----------|---|---|--|
| 34 | Peqin | Peqin , Karine, Gjocaj, Perparim, Pajove, Sheze | idem | 67% e te intervistuarve jane dakord parimisht per nevojen e nje reforme territoriale 76% mbeshtetin versionin specifik te ndarjes se njesise se Peqinit |
| 35 | Permet | Permet , Ballaban, Suke, Dishnice, Kelcyre, Qender, Frasher, Petran, Carcove | idem | 66% e te intervistuarve mbeshtetin ne parim nevojen per nje ndarje te re territoriale 76% e te anketuarve jane dakord me variantin specifik te ndarjes se njesise se Permetit |
| 36 | Pogradec | Pogradec , Hudenisht, Proptisht, Velcan, Trebinje, Dardhas, Bucimas, Cerrave | idem | 65% e te intervistuarve jane parimisht dakord per nevojen e nje ndarje te re territoriale 93% e tyre e mbeshtetin variantin specifik per njesine funksionale te Pogradecit |
| 38 | Puke | Puke, Fushe-Arrez , Fierze, Iballe, Blerim, Qafe-Mali, Gjegjan, Rrape, Qelez, Qerret | idem | 58% e te intervistuarve jane parimisht dakord per nevojen e nje reforme territoriale 77% e te anketuarve jane pro variantit specifik te ndarjes se nejsise funksionale te Pukes |
| 39 | Sarande | Sarande , Ksamil, Xarre, Konispol, Markat | Sarande , Ksamil, Xarre, Konispol, Markat, Lukove | 59% e te intervistuarve jane parimisht dakord per nevojen e nje ndarje te re te territorit 63% jane pro variantit 39 ne te cilin njesia e Sarandes perfshin edhe Lukoven 64% jane pro variantit 47 ne te cilin njesia e Sarandes nuk e perfshin Lukoven |
| 40 | Shijak | Shijak, Manez , Gjepalaj, Maminas, Xhafzotaj | Durres, Sukth, Shijak, Manez , Rrashbull, Katund I Ri, Ishem, Gjepalaj, Maminas, Xhafzotaj | 56% e te intervistuarve jane parimisht dakord per nje ndarje te re territoriale 40% jane pro variantit 39 ne te cilin Shijaku eshte pjese e Durresit nderkohe qe 47% jane kunder ketij varianti 75% jane pro variantit 47 ne te cilin Shijaku eshte njesi e vecante me 2 bashki dhe 3 komuna perberese |
| 41 | Shkoder | Shkoder , Ana e Malit, Berdice, Dajc, Guri I Zi, Postribe, Pult, Rrethine, | Shkoder, Vau i Dejes , Ana e Malit, Berdice, Dajc, Guri I Zi, Postribe, Pult, Rrethine, Shale, | 51% e te intervistuarve mbeshtetin parimisht nevojen per nje ndarje te re territoriale |

“Anketa e zërit të qytetarëve”

| | | | | |
|----|-------------|--|--|--|
| | | Shale, Shosh, Velipoje | Shosh, Velipoje, Temal, Shllak, Vig-Mnele, Hajmel, Bushat | 43% janë pro variantit 47 ne te cilin Shkodra dhe Vau I Dejes janë bashki me 15 komuna 44% janë pro variantit 39 ne te cilin Shkodra është bashki së bashku me 10 komuna |
| 42 | Skrapar | Polican, Corovode, Zhepe, Gjerbes, Leshnje, Potom, Cepan, Qender, Vendreshe, Bogove | idem | 83% e të intervistuarve mbështesin parimisht nevojën për një ndarje të re territoriale 79% janë pro variantit specifik për ndarjen e kësaj njësie territoriale |
| 43 | Tepelene | Tepelene, Memaliaj, Qender, Kurvelesh, Lopes, Qesarat, Krahes, Buz, Luftinje | idem | 67% e të intervistuarve mbështesin parimisht një ndarje të re të territorit në Shqipëri 80% mbështesin variantin specifik të ndarjes territoriale për njësinë e Tepelenes |
| 44 | Tirane | Tirana, Vore, Baldushk, Berxulle, Berzhite, Dajt, Farke, Kashar, Krrabe, Ndroq, Petrele, Peze, Preze, Shengjergj, Vaqarr, Zall Bastar | Tirana, Vore, Kamez, Zall Herr, Paskuqan, Baldushk, Berxulle, Berzhite, Dajt, Farke, Kashar, Krrabe, Ndroq, Petrele, Peze, Preze, Shengjergj, Vaqarr, Zall Bastar | 64% e të intervistuarve e mbështesin parimisht nevojën për një ndarje të re territoriale 56% janë pro variantit 39 ne te cilin njësinë e Tiranës përfshin edhe Kamzen 56% janë pro variantit 47 ne te cilin njësinë e Tiranës nuk e përfshin Kamzen |
| 45 | Tropoje | Bajram Curri, Lekbibaj, Bujan, Margegaj, Tropoje, Llugaj, Fierze, Bytyc | idem | 48% e të intervistuarve janë parimisht pro reformës territoriale ndërsa 38% e tyre janë kundër nevojës për një reformë të tillë 72% e tyre e mbështesin ndarjen specifike të variantit të propozuar për këtë njësi funksionale |
| 46 | Vau i Dejes | Vau I Dejes, Temal, Shllak, Vig-Mnele, Hajmel, Bushat | Shkoder, Vau I Dejes, Ana e Malit, Berdice, Dajc, Guri I Zi, Postribe, Pult, Rrethine, Shale, Shosh, Velipoje, Temal, Shllak, Vig-Mnele, Hajmel, Bushat | 63% e të intervistuarve janë parimisht dakord për nevojën e një reforme të tillë të për territorin 55% janë pro variantit 39 ne te cilin Vau I Dejes është pjesë e njësisë funksionale të Shkodrës 40% janë pro variantit 47 ne te cilin Vau I Dejes është njësi funksionale e vecante |
| 47 | Vlore | Vlore, Orikum, Selenice, Armen, Brataj, Kote, Novosele, Qender, Sevaster, Shushice, Vllahine | Vlora, Himara, Orikum, Selenice, Armen, Brataj, Kote, Novosele, Qender, Sevaster, Shushice, Vllahine, Vranisht | 58% e të intervistuarve e mbështesin parimisht nevojën për një ndarje të re të territorit 77% janë pro variantit 39 ne te cilin përfshihen dhe Himara me Vranishtin 67% janë kundër variantit 47 ne te cilin nuk përfshihen as Himara dhe as Vranishti nderkohe që vetëm 24% janë pro |

Zonat e reja – Varianti me 61 njesi

Pas kryerjes se anketimit, qe kishte konsideruar si baze kampionimi 47 zona funksionale te propozuara, harta e ndarjes territoriale ndryshoi me variantin prej 61 njesish duke shtuar 14 njesi te reja.

Me qellim qe te shihet nje tendence e mbeshtetjes per keto njesi te reja, nga kampioni i anketes se madhe u nxorren vetem qytetaret qe i perkisnin ketyre zonave dhe u rimoren ne telefon duke u kerkuar nje pergjigje mbi propozimin per njesine e re sipas variantit prej 61 njesish. Rezultatet e ketyre nenkampioneve duhen konsideruar vetem si indikative, sepse madhesia e tyre eshte relativisht e vogel per te pasur nje rezultat statistikisht te qendrueshem. Duhet thene se edhe shperndarja e tyre (numri i intervistave sipas komunave/bashkive) nuk eshte domosdoshmerisht sipas peshes qe zene njesite lokale ne konfiguracionin e ri te propozimit prej 61 njesish.

Rezultatet per njesite e reja jane si me poshte:

- Kelcyre
 - Te pyetur ne lidhje me mbeshtetjen apo kundersizimin per nje njesi te re te Kelcyres, ne nje shkalle nga 1 tek 7 ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*, qytetaret shprehin **mbeshtetje te larte** per kete variant me nje mesatare prej **6.7 pikesh** ne kete shkalle.
 - Rreth 97% e te anketuarve te kesaj zone deklarohen pro idese per njesine e re te Kelcyres.

- Memaliaj
 - Qytetaret e zonave qe perbejne njesine e re te Memaliajt, kane shprehur **mbeshtetje per kete variant** me nje mesatare prej **6 pikesh** ne nje shkalle nga 1 deri ne 7 ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Rreth 86% e te anketuarve per kete zone shprehen pro idese se njesise se re te Memaliajt. Vetem 14% jane kunder.

- Ura Vajguore
 - Edhe qytetaret e zonave qe perbejne njesine e re te Ures Vajguore, shprehin **mbeshtetje te larte per propozimin specifik** te ndarje se kesaj njesie me nje mesatare prej **6 pikesh** ne shkallen nga 1 deri ne 7 ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Rreth 87% jane pro dhe vetem 135 jane kunder per ndarjen e njesise se re te Ures Vajguore.

“Anketa e zërit të qytetarëve”

- Selenica
 - Nenkampioni i Selenices i pyetur për njesinë e re **nuk tregon mbështetje** për këtë variant me një mesatare prej **3.8 pikësh** (nën mesatare) në një shkallë nga 1 deri në 7 ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*. Ata që janë me kundërshtues ndaj këtij variant janë të anketuarit nga Kota (12 nga 15), Sevasteri (7 nga 9) dhe Brataj (5 nga 9).
 - Rreth 47% janë pro për Selenicën së njësi të re funksionale dhe 53% janë kundër kësaj ideje.
- Fushe Arrez
 - Qytetaret që vijnë nga zona përberese të njesisë së re funksionale Fushe Arrez, shprehin **mbështetje të lartë për këtë variant**, me një mesatare prej **6.1 pikësh** në shkallën nga 1 deri në 7 ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Rreth 82% e nenkampionit janë në mbështetje të krijimit të njesisë së re të Fushe-Arrezit.
- Libohovë
 - Qytetaret e kësaj zone, shprehin **mbështetje për këtë variant** me një mesatare prej **5.5 pikësh** në shkallën nga 1 deri në 7 ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Rreth 76% e nenkampionit të kësaj zone është në mbështetje të krijimit të njesisë funksionale të Libohovës dhe vetëm 22% janë kundër.
- Polican
 - Qytetaret që përbejnë nenkampionin e kësaj zone funksionale e **mbështesin variantin** për Policanin si njësi të re funksionale me një mesatare prej **6.2 pikësh** në një shkallë nga 1 deri në 7 ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Rreth 86% e të anketuarve në këtë zonë janë pro idesë së Policanit si njësi e re funksionale.
- Rrogozhinë
 - Qytetaret e kësaj zone, janë **mbështetes** për variantin e Rrogozhinës si njësi e re funksionale, me një mesatare prej **5.6 pikësh**, në shkallën 1 deri në 7, ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Afërsisht 77% e qytetarëve të këtij nenkampioni janë pro krijimit të njesisë së re funksionale të Rrogozhinës.
- Konispol
 - Qytetaret e Konispolit janë **mbështetes** të këtij varianti, me një mesatare prej **6.0 pikësh**, në një shkallë nga 1 deri në 7, ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.

“Anketa e zërit të qytetarëve”

- Deri ne 83% te nenkampionit te Konispolit mbeshtetin krijimin e njesise se re funksionale te Konispolit.
- Prrenjas
 - Qytetaret e kesaj zone **tregojne mbeshtetje te larte** per variantin e Prrenjasit si njesi e re funksionale me nje mesatare prej **6.1 pikesh** ne nga shkallen nga 1 deri ne 7, ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Rreth 87% te qytetareve te Prrenjasit mbeshtetin krijimin e njesise se re funksionale ne kete zone.
- Vore
 - Qytetaret e Vores **tregojne mbeshtetje** per variantin e ri, me nje mesatare prej **5.7 pikesh**, ne shkallen nga 1 ne 7, ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Rreth 82% te qytetareve nga nenkampioni i Vores, mbeshtetin variantin e Vores si njesi e re funksionale.
- Roskovec
 - Qytetaret e Roskovecit **tregojne mbeshtetje** per variantin e ri te kesaj njesie, me nje mesatare prej **5.8 pikesh**, ne shkallen nga 1 deri ne 7, ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Afersisht 83% te nenkampionit te Roskovecit, mbeshtetin variantin e Roskovecit si zone te re funksionale administrative.
- Klos
 - Qytetaret e kesaj zone **shprehin mbeshtetje** per Klosin si njesi te re funksionale, me nje mesatare prej **5.8 pikesh**, ne shkallen nga 1 deri ne 7, ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Rreth 81% te qytetareve te nenkampionit te Klosit, e mbeshtetin variantin e Klosit si njesi e re funksionale.
- Belsh
 - Qytetaret qe perbejne nenkampionin e kesaj zone **tregojne mbeshtetje te larte** per variantin e Belshit si njesi e re funksionale me nje mesatare prej **6.3 pikesh**, ne shkallen nga 1 deri ne 7, ku *1=Plotesisht Kunder* dhe *7=Mbeshtes Plotesisht*.
 - Rreth 91% e nenkampionit te qytetareve te Belshit e mbeshtetin ate si njesi te re funksionale administrative.

Metodologjia

Për të pasur një kampion/mostër sa më përfaqësuese të popullsisë, me një mundësi përzgjedhjeje të njëjtë apo të llogaritshme për çdo zonë/qytetar në moshë madhore të Shqipërisë, është hartuar një skemë e kujdesshme kampionimi.

Përzgjedhja e Njësive Primare të Kampionimit (NJPK)

- Territori i Shqipërisë është ndarë në 47 zona funksionale sipas variantit me më shumë zona të propozuar. Për secilën zonë është llogaritur popullsia përkatëse sipas Censurit të 2011. Kjo popullsi e çdo zone përfaqëson “popullatën” nga e cila do të përzgjidhet mostra për atë zonë specifike. Pra janë 47 mostra përfaqësuese të zonave funksionale të propozuara.
- Zonat janë kategorizuar në segmente të caktuara sipas popullsisë për të bërë një ndarje të madhësisë së kampionit për çdo segment popullsie. Madhësia minimale e kampionit/mostrës për zonat me popullsi më të vogël është N=200 dhe rritet në varësi të segmentit të popullatës. Tabela më poshtë paraqet këtë segmentim dhe madhësinë e kampionit përkatës.

| Popullsia | Nr. i Zonave Funksionale | Madhësia e kampionit | Toleranca e gabimit* | Total |
|------------------|--------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|
| > 25 000 | 14 | 200 | ± 6.8% | 2800 |
| 25 000 – 40 000 | 12 | 300 | ± 5.6% | 3600 |
| 40 001-60 000 | 7 | 350 | ± 5.2% | 2450 |
| 60 001 – 100 000 | 7 | 400 | ± 4.8% | 2800 |
| Over 100 000 | 6 | 500 | ± 4.3% | 3000 |
| Tirana | 1 | 1000 | ± 3.1% | 1000 |
| Total | 47 | | | <u>15 650</u> |

*Toleranca e gabimit është llogaritur për një interval besueshmërie 95%, që përfaqëson standartin tipik të hulumtimeve sasiore. Teknikisht, numri i përfaqësuar nga toleranca e gabimit nënkupton që, nëse merren në mënyrë të përsëritur kampione të kësaj madhësie, 95% e tyre do të pasqyrojnë opinionet e popullatës me pasaktësi jo më të madhe se toleranca e gabimit.

“Anketa e zërit të qytetarëve”

- Brenda një zone funksionale, si Njësi Primare të Kampionimit, shërbejnë zonat gjeografike më të vogla të përcaktuara nga Qendrat e Votimit sipas zgjedhjeve më të fundit parlamentare të 2013.
- Brenda zonave funksionale bëhet një shtresëzim i Njësive Primare të Kampionimit sipas parametrave Urban apo Rural (Bashki/Komuna) dhe pastaj sipas Njësive të qeverisjes vendore përkatëse. Ky shtresëzim shërben që të sigurohemi se çdo njësi e qeverisjes vendore aktuale do të ketë përfaqësim në kampion.
- Një algoritëm specifik, bën përzgjedhjen e Njësive Primare të Kampionit duke përdorur si parameter madhësi për to, numrin e votuesve për çdo Qendër Votimi. Kjo është lidhur drejtpërdrejtë edhe me targetin e anketës që synon qytetarët në moshë madhore (18 vjeç e sipër).
- Brenda çdo njësie primare të përzgjedhur, që përfaqëson një zonë të caktuar gjeografike kryhen 10 intervista.

Përzgjedhja e Derës/Shtëpisë ku do të trokitet

- Brenda njësive primare të përzgjedhur ka një metodologji specifike sipas të cilës përzgjidhen dyert ku trokitet për të bërë një intervistë – “Metodologjia e rrugës rastësore”.
- Çdo anketuesi i jepet harta e njësive përkatëse dhe i përcaktohet pika fillestare e lëvizjes (një adresë specifike, një kryqëzim, një ndërtesë e caktuar) nga supervizori.
- Duke ruajtur gjithmonë krahu e djathtë intervistuesi fillon numërimin e shtëpive rezidenciale nëpërmjet një hapi të përcaktuar që ka marrë parasysh dendësinë e familjeve në zonë (p.sh. 1 në çdo 3 dyer apo 1 në çdo 5 dyer).
- Dera së ciles i bie numërimi sipas hapit të përcaktuar është banesa e përzgjedhur për të kryer intervistën.
- Intervistuesi duhet të zbatojë metodologjinë e përzgjedhjes së personit brenda familjes/banesës dhe të rezervojë mundësinë për të bërë deri në 3 vizita në këtë banesë përpara se të vendosë ta zëvendesojë atë me një banesë tjetër (në kushte kur nuk është e mundur të kryhet intervista)

Përzgjedhja e Personit që do të intervistohet

- Brenda banesës së përzgjedhur, duhet të gjendet personi i cili duhet të intervistohet sipas metodologjisë së përcaktuar.
- Intervistuesi duhet të zgjedhë personin madhor (18 vjeç e sipër) brenda familjes/banesës që ka pasur ditëlindjen e fundit nga data e kontaktit për intervistë.

“Anketa e zërit të qytetarëve”

- Personat duhet të jenë “rezidentë” në familje/banesë (të kenë jetuar për të paktën 6 muaj në 12 muajt e fundit).

Intervistuesit

187 intervistues u angazhuan për të mbledhur të dhënat në terren. Të gjithë intervistuesit fillimisht kaluan në një fazë trajnimi intensiv përsa i përket:

- i) Informacionit mbi reformën në përgjithësi
- ii) Informacin mbi ndarjen specifike të zonës funksionale ku ata do të ishin intervistues. Ata u pajisën me hartat përkatëse të zonave si dhe me një dokument informativ mbi parimet dhe përmbajtjen e reformës.
- iii) Trajnim i detajuar mbi pyetësoin e ndërtuar për anketim

4 Koordinatorë terreni dhe 12 supervizore kanë monitoruar punën e intervistuesve duke u kujdesur të verifikojnë të gjitha detajet mbi ndjekjen e metodologjisë në terren dhe kryerjen cilësore të intervistave. Kontrollë rastesore dhe të strukturara janë kryer si në terren edhe në zyre duke rikontaktuar dhe ripyetur të intervistuarit e zonave të ndryshme.

IDRA zbaton kodin e Esomarit, www.esomar.org (standartin ndërkombëtar për hulumtime të opinionit publik) dhe Ligjin shqiptar “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Nr. 9887, dt. 10/03/2008) në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale. Të dhënat e anketës përdoren vetëm për qëllime statistikore.